



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 365/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditëses nga Mitrovica te cilën e përfaqëson Av. , kundër te paditurës Komuna e Mitrovicës, te cilin e përfaqëson për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin ne emër te pagave përcjellëse për ne pension, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, ne prezence te autorizuarit te paditëses dhe përfaqësuesit te te paditurës, gjykata me dt. 10.01.2017, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. OBLIGOHET** e paditura t'ia paguajnë paditëses ne emër te pagesës se 3 pagave për shpërblim jubilar pas pensionimit për periudhën e punës prej 34 vjeçare si mësimdhënëse te e paditura, shumen prej **1,421.73 euro**, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej **1,421.73 euro**, respektivisht, ne emër te 6 pagave shuma totale prej **2,843.46 euro (dy mije e tetëqind e katërdhjetë e tri euro e katërdhjetë e gjashte cent)**, me kamat sipas lartësisë që paguhet për një vit në bankat afariste për mjetet e depozituar pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit te padisë, dt.01.07.2016, e gjer ne përmbushjen definitive te detyrimit.

**II. OBLIGOHET** e paditura t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 264 Euro, ndërsa gjykatës ne emër te përpilimit te këtij aktgjykimi t'i paguaj shumen prej 25 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

## Arsyetim

Paditësja, përmes te autorizuarit te saj, ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension.

Gjykata, me dt. 21.12.2016, ka caktuar seancës për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësës Av. \_\_\_\_\_ dhe përfaqësuesi ligjor i te paditurës \_\_\_\_\_

Ne fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit, deklaroi: mbetem ne tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë se ushtruar me shkrim, konsideroj se nga provat e nxjerra ne procedurë ne mënyrë te pa kontestueshme u vërtetua bazushmeria e kërkesëpadisë, andaj gjykatës i propozoi qe te njëjtën ta aprovoi ne tersi te bazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi ligjor i te paditurës \_\_\_\_\_ deklaroi: E kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë për arsye se deri me tani nuk ka rregullativ te akteve juridike qe e njohin këtë te drejt, pavarësisht ekzistimit te një kontrate kolektive si kontratë e përgjithshme kolektive, për te paditurën baza e se njëjtës do te kishte ekzistuar sikurse ne rastin e saj do te kishte kontratë kolektive sektoriale ose qe nënkupton lamin e arsimit, prandaj duke mbetur ne përgjigje shkresore te Drejtorisë se Arsimit, propozoi gjykatës qe kërkesëpadinë ta refuzoi si te pa bazuar.

Gjykata, ne procedurën e leximit te provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: vërtetimin e lëshuar nga SHMU " \_\_\_\_\_ Mitrovicë me nr. protokolli \_\_\_\_\_, dt. \_\_\_\_\_ vërtetimin e lëshuar nga Shkolla fillore e mesme e ulet " \_\_\_\_\_ Mitrovicë me nr. protokolli \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_ përgjigjja e dhënë nga e paditura e dt. \_\_\_\_\_, pasqyra e llogarisë dhe e pagës se bere për paditesen e lëshuar nga Procredit Bankë e lëshuar \_\_\_\_\_ endimi i te paditurës për pushimin e marrëdhënies se punës nr. \_\_\_\_\_ vendimi i MPMS-Departamenti I Pensioneve dt \_\_\_\_\_ me te cilin konstatohet se paditësja është pensionuar me datën \_\_\_\_\_ pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti qe paditësja \_\_\_\_\_ ka qene punëtore te e paditura Kor \_\_\_\_\_ si mësimdhënëse ne " \_\_\_\_\_ Mitrovicë dhe Shkollën fillore e mesme e ulet ". \_\_\_\_\_ Mitrovicë.

Nuk është kontestues fakti se paditësja ka punuar te e paditura pandërprerë qe nga data \_\_\_\_\_, 1 gjer me datën \_\_\_\_\_, respektivisht, periudha kohore e punës pandërprerë e paditësës te e paditura ka qene 34 vite e me tepër.



Nuk është kontestues fakti se me vendimin MPMS-Departamenti I Pensioneve paditësja është shfrytëzues I pensionit kontributiv ne shume prej 140 euro qe nga data e pensionimit.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto qe paditësja e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 473.91 euro.

Gjykata për vendosje sipas pikës 1 te dispozitivit sa i përket pagesës se tri pagave ne emër te shpërblimit jubilar iu referua nenit 36 par 9 nenpar 9.3 dhe 9.4 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës me te cilën parashihet se "punëmarrësi I cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi I fundit ti njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne vlere-lartësia te tri pagave mujore te tij" ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ne emër te kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua ne nenin 10 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës me te cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse te tri pagave mujore qe i ka marre ne tre muajt fundit.

Bazuar ne nenin 36 par.9.4 te Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës është detyrim i punëdhënësit te fundit këtu te paditurës qe ti paguaj kompensimin për dy kategori te lartcekura.

Nga shkresat e lendes konstatohet se edhe përkundër kërkesës qe paditësja i ka parashtruar te paditurës për pagesën këtyre kompensimeve e njëjta nuk ka vepruar sipas obligimit nga neni 36 par 9 nenpar.9.5 i Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës, gjegjësisht ne afat prej një muaji nga data e parashtrimit te kërkesës nga ana e paditësit nuk i ka bere kompensimin e këtyre pagave me arsyen se ne Ligjin e Punës nuk janë parapa kompensime te tilla.

Gjykata kur ka vendosur sipas pikës 1 te dispozitivit sa i përket pagesës se tri pagave ne emër te shpërblimit jubilar, përveç Kontratës Kolektive te Arsimit Para universitar te Kosovës, iu referua edhe nenit 52 par 1 nenpar 1.3 te Marrëveshjes se përgjithshme kolektive te datës 18.03.2014, me te cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne vlere-lartësia te tri pagave mujore te tij" ndërsa gjykata me rastin e vendosjes ne emër te kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua ne nenin 53 te marrëveshjes kolektive me te cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse te tri pagave mujore qe i ka marre ne tre muajt fundit.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet-kundërshtimet e te paditurës e cila pretendon se nuk ka kontratë kolektive sektoriale ne lëmin e arsimit, mirëpo te njëjta gjykata i refuzoi si te pabazuara për arsye se nënshkruese e kësaj

kontrate është edhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, kështu që bazuar në arsyet e mësipërme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, lidhur me përlllogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 277 par 1 të LMD-se, ndërsa lartësinë e saj e caktoi mbi bazën e lartësisë së kamatës që paguhet në mjetet e afatizuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro në emër të përpilimit të padis dhe 25 euro në emër të taksës për padë, ndërsa për shpenzime gjyqësore, u bazua në nenin 10.12, në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Unifikim të Taksave Gjyqësore nr. 2008/2.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-se.

### **GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**

**C.nr.365/16 data 10.01.2017**

**GJYQTARI**

**Naim Mehulli**

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSITË E KOPJES E VËRTETË  
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОС КОПИЈЕ

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćení radnik

